



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 25
Prishtinë, më 06 prill 2016, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-II

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Synavere Rysha, Hajdar Beqa, Naim Fetahu, Fikrim Damka dhe Abdyl Ymeri.

Munguan: Besnik Bislimi, Bali Muharremaj dhe Enver Hoti.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatorë e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës, Fehmi Pireva – Zyrtar ndërlidhës për Agjencitë e Pavarura- Kuvend dhe Mentor Hyseni, ekspert nga GIZ-i.

Pjesëmarrësit e tjerë në takim: Besnik Osmani - ZAP, Artan Venhari - ZAP, Ibrahim Gylderren - ZAP, Ilire Daija- Buza- ZAP, Artan Murati - KDI, Dren Ajeti - GLSP, Blerta Bejtullahu - EUSR/EU Office, Sanije Berisha - OSBE, Rrahman Ramaj - Birn, Besmir Rokollari - ICHAT, Liridona Xhemajli - RTV-21 dhe Norë Shabani- Koha Ditore.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.03.2016;
3. Takim i Komisionit me auditorin e përgjithshëm, z. Besnik Osmani;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Përfundimtar për Projektligjin Nr.05/L-055 për auditorin e përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës;
5. Diskutim për raportet kthyesë të organizatave buxhetore, për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike;
6. Të ndryshme.

Zëvendëskryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Zëvendëskryetari konstatoi që aprovohet rendi i ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.03.2016

Zëvendëskryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 23.03.2016, pa vërejtje.

3. Takim i Komisionit me auditorin e përgjithshëm, z. Besnik Osmani

Ali Sadriu, zëvendëskryetar, i njoftoi deputetët me auditorin e përgjithshëm, i cili tani para pak ditësh ka marrë pozitën e auditorit të përgjithshëm, në të njëjtën kohë i dëshiroi punë të mbarë. Me këtë ia dha fjalën.

Besnik Osmani, auditor i përgjithshëm, i falënderoi deputetët e Komisionit për mbështetjen që ia kanë dhënë me rastin e votimin të propozimit të Presidentes për emrin e tij, dhe po ashtu për votimin në seancë për kandidatin e propozuar për auditor të përgjithshëm. E kuptoj peshën dhe rëndësinë që ka auditori i përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, dhe do të mundohem ta avancojë dhe forcojë këtë Zyrë.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Përfundimtar për Projektligjin Nr.05/L-055 për auditorin e përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

Ali Sadriu, zëvendëskryetar, theksoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP), në pajtim me nenet 57, 67 dhe 68 të Rregullores të Kuvendit, në disa mbledhje të mbajtura shqyrtoi Projektligjin për auditorin e përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria. Projektligji Nr. 05/L-055 për auditorin e përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, së bashku me amendamentet e miratuara nga Komisioni Funksional, më 23.03.2016, është proceduar në komisionet kryesore të cilat për një kohë relativisht të shkurtër kohore kanë shqyrtuar Projektligjin bashkë me amendamentet e Komisionit Funksional. Ku në rastin konkret del se amendamentet e KMFP për projektligjin nuk cenojnë dhe nuk janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, qoftë vendor, po ashtu edhe atij të Bashkimit Evropian.

Gjatë shqyrtimit të Projektligjit KMFP ka arritur t'i nxjerrë 17 amendamente, të cilat tani janë në materialin e përgatitur nga administrata e Komisionit.

Po ashtu, stafi i Komisionit ka pranuar raportet e komisioneve të përhershme, të cilat nuk kanë dhënë vërejtje në amendamentet tona, dhe kanë konstatuar se nuk bien ndesh me ligjet e zbatueshme në Kosovë. Megjithatë unë mendoj se aktualisht nuk është momenti që të aprovojme raportin përfundimtar të projektligjit para se të shterën të gjitha diskutimet. Me këtë e hapi diskutimin.

Naim Fetahu theksoi se Projektligji Nr. 05/L-055 për auditorin e përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, është diskutuar gjatë në KMFP. Megjithatë sa

i përket auditimit të subjekteve politike do të duhet të diskutohet me gjatë, sepse kemi komente shtes në lidhje me këtë, po ashtu do t'i japim edhe auditorit të ri një mundësi shtesë për propozime. Megjithatë kam edhe një vërejtje sa i përket mediave që po i japin një publicitet të panevojshëm çështjes së auditimit të subjekteve politike.

Fikrim Damka theksoi se Projektligji për auditorin e përgjithshëm, është një Ligj me një rëndësi të madhe dhe propozojë të mos ngutemi me procedimin e këtij Projektligji, pa u diskutuar të gjitha sugjerimet nga partnerët që mbështesin Komisionin, pse jo edhe nga auditori i përgjithshëm.

Abdyl Ymeri theksoi se unë personalisht kam lexuar me shumë kujdes të dhënat në raportin e përgatitur, si dhe rekomandimet e komisioneve të përherëshme, mendojë së aktualisht deri tani KMFP ka kryer punën e vet, pa dashur të humbim kohë me këtë, do të propozoja që të vendosim për adresim të raportit përfundimtar të Projektligjit.

Hajdar Beqa shtoi se është bërë një punë e madhe, nga të gjithë ne me këtë projektligj. Sidoqoftë nëse është e nevojshme ne mund të takohemi për t'i diskutuar çështjet e ngritura. Ne e kemi diskutuar edhe çështjen e auditimit të subjekteve politike, dhe kemi marrë një vendim unanim në Komision, po ashtu nuk kemi pasur kundërshtime as nga komisionet e përherëshme në lidhje me këtë çështje.

Synavere Rysha tha se është bërë një punë e mirë dhe është punuar gjatë në këtë projektligj. Ajo që mendoj se duhet të diskutohet prapë është amendamenti që ka të bëjë me auditim të subjekteve politike, të cilat edhe ashtu kanë mbetur tri vjet të pambuluara me auditim. Mendoj se, nëse në këtë projektligj mbetet që ZAP-i t' i auditojë subjektet politike atëherë, po mbesin të përjashtuara BQK, TKPK, dhe ndërmarrjet publike. Po ashtu edhe zgjedhja e zëvendësauditorit nga Kuvendi nuk do të duhej të bëhej, më vjen shumë mirë që kjo pikë nuk është përkrahur edhe nga komisionet e përherëshme.

Hajdar Beqa theksoi se nuk ka pasur rekomandim për mënyrën e zgjedhjes së zëvendësauditorit dhe për këtë, nuk kemi pasur qëndrim të komisioneve të përherëshme, sepse ne paraprakisht jemi pajtuar të gjithë që kjo çështje të mbetet si në projektligj.

Ali Sadriu, zëvendëskryetar, pasi nuk pati të interesuar për të diskutuar, propozoi që KMFP të mblidhet të martën më 12.04.2016, për të vazhduar me plotësimin e amendamenteve për Projektligjin Nr. 05/L-055 për auditorin e përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Përfundim

KMFP nuk aprovoi raportin përfundimtar të Projektligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, dhe vendosi që këtë raport ta diskutojë edhe një herë në takimin e radhës së Komisionit.

4. Diskutim për raportet kthyesë të organizatave buxhetore, për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike

Ali Sadriu, zëvendëskryetar, njoftoi deputetët dhe të pranishmit se administrata e Komisionit ka mbajtur një evidencë të rekomandimeve të KMFP, të cilat janë dhënë nga Komisioni, si dhe nga seanca plenare për vitin 2015. KMFP, me rastin e shqyrtimit të raporteve të auditimit të PVF-ve të përgatitura nga ZAP për vitin e kaluar ka arritur të shqyrtojë 58 raporte të auditimit, duke përfshirë këtu edhe raportin vjetor të auditimit të ZAP-it për vitin 2013 dhe 2014.

Gjatë shqyrtimit të raporteve të auditimit KMFP ka arritur t'i nxjerrë mbi 84 rekomandime, ku një pjesë e këtyre rekomandimeve kanë kaluar edhe përmes seancës plenare.

Vlen të theksohet se një pjesë e rekomandimeve kanë qenë të lidhura me afate kohore, megjithatë shumica prej këtyre organizatave buxhetore nuk kanë kthyer raportet kthyesë sipas afateve kohore të caktuara me rekomandime. Rekomandimet janë dhënë për këto Organizata Buxhetore: Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Shërbimin Policor të Kosovës, Doganën e Kosovës, Këshillin Gjygjësor të Kosovës, Ministrinë e Administratës Publike, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Integritetit Evropian.

Aktualisht deri tani raporte kthyesë kanë dorëzuar këto Organizata Buxhetore edhe atë: Ministria e Integritetit Evropian, lidhur me raportin e auditimit të PVF-ve për vitin e përfunduar, më 31 dhjetor të vitit 2014. Ministria e Shëndetësisë, lidhur me raportin e auditimit për performancën e prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë. Ministria e Financave, përkatësisht Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm, lidhur me auditorët e brendshëm dhe funksionalizimin e njësive të auditimit. Vlen të theksohet se një numër i konsideruar i rekomandimeve kanë dalë nga shqyrtimi i raportit vjetor të auditimit për vitin 2013 dhe për vitin 2014. Duke pasur parasysh situatën në të cilën jemi, ku aktualisht nuk kemi raporte të auditimit në pritje për shqyrtim, mendojmë se është momenti i duhur që në takimet e radhës të orientohemi për shqyrtimin e raporteve kthyesë të organizatave buxhetore. Me këtë e hapi diskutimin.

Hajdar Beqa tha se është mirë që Organizatave Buxhetore të ju jepet një afat kohor prej 30 ditëve që t'i kompletojnë planet e veprimit për adresimin e rekomandimeve, dhe pas këtij afati kohor t'i dorëzojnë në KMFP. Pastaj mund të kërkojmë një pikë të rendit të ditës në një seancë të Kuvendit.

Abdyl Ymeri shtoi se për ato organizata buxhetore të cilat nuk kanë dorëzuar planet e veprimit të u jepet një afat kohor shtesë prej 10 ditësh, në mënyrë që t'i dorëzojnë planet e veprimit. Unë mendoj se 10 ditë janë të mjaftueshme, sepse kanë staf mjaft që brenda këtij afati mund ta hartojnë një plan të veprimit.

Synavere Rysha tha se një rëndësi të veçantë e ka, implementimi i rekomandimeve të dhëna nga ZAP, KMFP dhe seanca plenare, për organizatat buxhetore. Prandaj mendoj se ju duhet një afat kohor shtesë për këtë, dhe pajtohem që t'ju shkruajmë një shkresë ku do të kërkohet raport kthyes brenda afatit prej 30 ditësh.

Naim Fetahu theksoi se një afat kohor shtesë prej 30 ditëve, është i rëndësishëm për t'ju dhënë mundësi organizatave buxhetore t'i përgatisin planet e veprimit, sepse pa këto plane të veprimit

nuk mundet KMFP të marrë vendime të duhura se sa janë zbatuar dhe si janë zbatuar rekomandimet tona.

Ali Sadriu, zëvendëskryetar, tha se stafi i KMFP të përgatisë shkresë për të gjitha organizatat buxhetore, të cilat nuk i kanë dorëzuar planet e veprimtimit ashtu siç janë kërkuar me rekomandimet individuale të KMFP.

Alensandra Fehlinger theksoi se rekomandimet e dala për organizata buxhetore janë të lidhura me të gjeturat e Raportit Vjetor të Auditimit për PVF për vitin e kaluar. Rekomandime këto të cilat kanë kaluar përmes seancës plenare. Bazuar në këtë mendim se shkresa për këto organizata duhet të shkojë nga Kryetari i Kuvendit, e jo nga kryetari i KMFP-së. Rekomandimet kanë qenë të afatizuara nga janari, marsi dhe fundi i qershorit të vitit 2016. Eksperti gjerman që punon për GIZ ka sugjeruar se shkresa duhet të bëhet nga Kryetari i Kuvendit, dhe për këtë t' i jepen afatet kohore për raportin kthyes.

Ali Sadriu, zëvendëskryetar, shtoi se KMFP ka përgatitur dy lloj rekomandime, ato të cilat janë adresuar për seancë plenare, si dhe ato rekomandime të cilat kanë shkuar në organizata buxhetore nga KMFP. Andaj ne, si KMFP, duhet të kërkojmë raporte kthyes për ato organizata buxhetore që rekomandimet tona janë adresuar direkt në organizata buxhetore. Ndërsa për rekomandimet tona që kanë shkuar përmes seancës plenare, përgjegjësia për këtë duhet të jetë e Kryesisë së Kuvendit dhe Kryetarit të Kuvendit. Me këtë mbylli këtë pikë të rendit të ditës me këtë përfundim.

Përfundim

Administrata e KMFP të përgatisë, shkresa të veçanta për të gjitha organizatat buxhetore të cilat nuk kanë dorëzuar raportet kthyes për planet e veprimtimit për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga KMFP, duke ju caktuar afatin kohor prej një muaji.

5. Të ndryshme

Nuk pati diskutim në këtë pikë. Me këtë u mbyll takimi.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zëvendëskryetari i Komisionit

Ali Sadriu